- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'ë realizojmë për Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), punimet për [vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE] në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në preventiv, me të gjitha projektet teknike, e me kërkesat në detyrën e projektimit apo termat e referencës, nëse është rasti, dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.**
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
  - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  - 2. Njoftimin e Kontrates;
  - 3. Kriteret e Vlerësimit;
  - 4. Kriteret e Përzgjedhjes;
  - 5. Specifikimet teknike, Projektet dhe çdo dokumentacion teknik;
  - 6. Preventivin e çmimeve
  - 7. Termat e referencës (nëse është rasti)
  - 8. Detyrën e projektimit (nëse është rasti)
  - 9. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  - 10. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	

**Shtojca 2.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

**Oferta ekonomike e detajuar**

<b>Nr</b>	<b>Nr. Analizë</b>	<b>Përshkrimi i Punëve</b>	<b>Njësi</b>	<b>Sasia</b>	<b>Çmimi/ Njësi</b>	<b>Cmimi total</b>
1.						
2.						
3.						
<b>Shuma</b>						
<b>Fondi Rezervë</b>						
<b>Shuma</b>						
<b>TVSH</b>						
<b>SHUMA TOTAL</b>						

**Nënshkrimi i ofertuesit** \_\_\_\_\_**Vula****Shënim:** Çmimet duhet të shprehen në Monedhën \_\_\_\_\_ ( e kërkuar në dokumentat e tenderit )



**Shtojca 3.**

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS**

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedhadhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

**Shtojca 4.**

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

**Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

**VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit****Nënshkrimi****Vula**

**Shtojca 5.**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/ Kontraktor* ]

**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

**Të dhënat teknike të punëve objekt prokurimi duhet** të përshkruhen sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

SHËNIM: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**Sipas materialit bashkëlidhur dokumenteve standarte të tenderit.**

## Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/ Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/ kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE

Afatet e realizimit të punimeve:

GRAFIKU PUNIMESH						
"Ndërtim Rrjeti KUZ (kanalizime të ujërave të zeza) Fshati Bolens", Bashkia Himarë						
Nr	Nr.an	Përshkrimi i procesit të punimeve	Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3	Muaji 4
<b>Kanalizimet</b>						
<b>Punime Dheu</b>						
1	3.90/a	Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m <sup>2</sup> , në kanale gjeresi deri 2 m, prani të kategorisë III, me shk në nyjt				
2	3.45/1	Gërmim kanalesh në toke të zakonshme, me krahe, me seksion deri 0.75 m <sup>2</sup>				
3	2.258	Mbushje me material të zëpuruar				
4	An.164/1 a	Mbushje me material të dalë nga gërmimet				
5	2.261	Mbushja me rërë për shtratin dhe mbulesën mbrojtëse për tubat CHDPE				
6	3.158/5a	Transporti i materialit të mbetur nga gërmimet me kamion deri në 5 km.				
7	3.47/1b	Rrafshim ngjeshje me tokmak elektrik, oda 30 cm, toke zak				
8	An	Mbrojtja e Kanalit Me Pflankola				
<b>Rehabilitimi i sipërfaqeve</b>						
9	An	Prerja, prishja dhe rikthimi në gjendjen fillestare i sipërfaqeve me beton				
10	An	Prerja, prishja dhe rikthimi në gjendjen fillestare i rrugëve të asfaltuara				
<b>Punime të tubacioneve</b>						
1	3.An/11-1 Ref	F V tuba të brinjëzuar HDPE S18 d=200 mm				
2	3.An/11-2 Ref	F V tuba të brinjëzuar HDPE S18 d=250 mm				
3	3.An/11	F V tuba të brinjëzuar HDPE S18 d=315 mm				
4	3.An/21	F V tuba të brinjëzuar HDPE S18 d=400 mm				
<b>Pusetat</b>						
1	An-20	Pusetat shkarkimi bl.a. 80 x 80 cm, h = 100 cm				
<b>Gropat, Septika</b>						
1	3.88/a	Gërmim themel (gropa) sip 10-30m <sup>2</sup> , shembë bute h= 2.5m,shkarkimi				
2	3.19/a	Hedhje matësor mbushje dheu, kg/iv				
3	3.245	Shtresa betoni C 25/30 ( gropë septike )				
4	3.243	Shtresa betoni C 16/20 ( gropë septike )				
5	2.88	F.V. Mure blloqe betoni ( gropë septike )				
6	3.288	F.V Hekur ( gropë septike )				
7	2.258	Shtresa gjalitë 1000mm, t = 10cm				
8	2.506	Fv Tub çeliku DN 100mm për ajrues				
9	3.837	Rindim vepr pastrimi kolona çdo 2m rrjetit gabioni rtel me gjemba				
10	3.290/1	Fv porta metalike (2 x 1)m				
11	An-05	Fv Furg kloni 100 litra mbt gropën septike				
12	2.623/1	Tub plastik i brinjëzuar DN 200 për shkarkim				
13	3.158/5a	Transporti i materialit të mbetur nga gërmimet me kamion deri në 5 km.				
<b>Mbrojtja e shtresës</b>						
<b>Punime Dheu</b>						
1	3.99/a	Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m <sup>2</sup> , në kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategorisë III, me shk në nyjt				
2	3.45/1	Gërmim kanalesh në toke të zakonshme, me krahe, me seksion deri 0.75 m <sup>2</sup>				
3	2.261	Mbushja me rërë për shtratin dhe mbulesën mbrojtëse për tubat CHDPE				
4	3.158/5a	Transporti i materialit të mbetur nga gërmimet me kamion deri në 5 km.				
5	An.164/1 a	Mbushje me material të dalë nga gërmimet				
6	An	Prerja, prishja dhe rikthimi në gjendjen fillestare i sipërfaqeve me beton				
7	An	Prerja, prishja dhe rikthimi në gjendjen fillestare i rrugëve të asfaltuara				
<b>Tubacione - tuba, rakorden, ndihmëse për punët e shtrimit</b>						
1	3.An/13-3 Ref	F V tuba të brinjëzuar HDPE S18 d=160 mm				
2	3.An/11-1 Ref	F V tuba të brinjëzuar HDPE S18 d=200 mm				
<b>Pusetat</b>						
1	An-19	Pusetat shkarkim bl.a. 80 x 80 cm, h = 100 cm				

Shënim. Autoriteti/ kontraktor mund të shtojë rreshta në varësi të zërave të punimeve dhe kollona në varësi të afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

Sipas materialit bashkëlidhur dokumenteve standarte të tenderit.

## Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që vepron si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

### 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

### 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

#### 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

#### 2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

#### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë sa vlera e përlllogaritur/fondi limit i kontratës.

❖ ***Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomik arrijnë vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.***

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020,2021,2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

❖ ***Shënim: Bilancet vjetore duhet të shoqërohen me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenin 13 të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin" dhe nenin 41 të Ligjit 10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar".***

#### 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në zbatimin e punimeve të ndërtimit:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet;

b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, të jetë në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

**Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim.** Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
  - Kontratë Sipërmarrje
  - Situacionin përfundimtar,
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
  - Kontrate Sipërmarrje;
  - Situacionin përfundimtar;
  - Akt kolaudimi objekti;
  - Çertifikatën e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.
  - Fatura tatimore për çdo situacion punimesh.

**2.3.2** Operatori Ekonomik ofertues për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të zotërojë Liçenca Profesionale të lëshuar nga MPPT/MTI ose nga institucionet e autorizuar me ligj si më poshtë:

**Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**

**NP-1 A** Punime gjurmimi në tokë .

**NP-7 A** Ujesjellësa , gazsjellësa , vajsjellësa , vepra kullimi e vaditje

**Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**

**NS-1 A** Punime për prishjen e ndertimeve.

**NS-18 A** Punime topogjeodezike

- sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licencave profesionale sipas legjislacionit në fuqi;

*Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës. Në rast të shpalljes fitues të një operatori ekonomik të huaj, ky i fundit do të ekuivalentojë licencën sipas legjislacionit përkatës.*

**2.3.3** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë drejtues teknik në licencën e shoqërisë për këtë objekt të vërtetuar me kontratë noteriale pune të vlefshme, diplomë, CV, Librezat e punës, dhe të figurojnë në listëpagesa për periudhën Nëntor 2022- Janar 2023 si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Topograf 1 (një)
- Inxhinier Mekanik 1 (një)
- Inxhinier Gjeolog 1 (një)

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese së inxhinierët e deklaruar në kërkesën 2.3.3 për kualifikim janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate dhe nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

### **Autoriteti Kontraktor rezervon të drejten të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.**

Kriteri sipas pikes 2.3.3 do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit . Operatori ekonomik i kualifikuar i pari ne klasifikim duhet te dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit , të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar si staf teknik te pajisur me diploma/certifikata te arsimit profesional si dhe certifikata te sigurimit teknik te leshuara nga shoqeri te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, si dhe të rezultojnë në listpagesat e shoqërisë për në listëpagesa për periudhën Nëntor 2022- Janar 2023 minimalisht si më poshtë:

- Punonjës Teknik Ndertimi 1 (një)
- Punonjës Teknik Hidraulik 1 (një)
- Punonjës Hidraulik 3 (tre)
- Punonjës Hekurkthyes 2 (dy)
- Punonjës Murator 2 (dy)
- Punonjës Saldimi 1 (një)
- Punonjës Mekanike 1 (dy)
- Manovratore 3 (tre)

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

- Kontratën individuale të punës;
- një dokument (diplomë,certifikate e arsimit profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm)
- Certificate te sigurimit Teknik e vlefshme, leshuar nga institucione te autorizuar nga /ish (IQT) e cila te jete e leshuar nga shoqeri te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise
- **Diplomë** nga institucionet e arsimit të mesëm profesional(publik/privat) të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”, kontratë pune të vlefshme dhe të figurojë në listëpagesa.
- Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit te marredhenieve te punes	Nr. Amzes/ekuivalent i diplomes/certifikates profesionale	Institucioni/Subjekti certifikues	Data e vlefshmerise se certifikates profesionale

**2.3.5** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në stafin teknik mbështetës të punësuar të vërtetuar me kontrate pune te vlefshme, si dhe të figurojnë në list pagesat e shoqërisë për per në listëpagesa për periudhën Nëntor 2022- Janar 2023

- a) 1 (një) punonjes inxhinier të disponojë çertifikatë/deshmi si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë” de V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", (i ndryshuar), lëshuar nga organizatë shqiptare ose e huaj e njohur në Republikën e Shqipërisë, të shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme,diplome/certifikatë si dhe te figuroje ne list pagesa per periudhen Shkurt 2022-Prill 2022
- b) 1 (një) punonjes inxhinier i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**2.3.6** Numri mesatar i punonjësve duhet të jetë jo më pak se **30 (tridhjetë ) punonjës.**

Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:



a) Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore.

b) Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

**Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.**

**2.3.7** Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me liçencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B “Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e Mbetjeve Urbane”, sipas parashikimeve ligjore në Ligjin Nr.9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”(Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, datë 11.05.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”) Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25.

**2.3.8** Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë të cilësisë së punimeve **ISO 9001 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë - e vlefshme)**. (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO nderkohe që secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).

**2.3.9** Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë **ISO 14001 (Sistemi për menaxhimin mjedisor -e vlefshme)**. (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO nderkohe që secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).

**2.3.10** Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë **ISO 45001 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë -e vlefshme)** (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO nderkohe që secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).

Të gjitha certifikatat e mësipërme, duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilët janë të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues.

**2.3.11** Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe paisjet teknike që ka në dispozicion të cilat janë si më poshtë vijon:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamiona vetshkarkues me kapaciteti mbajtës 10 – 20 ton per secilin kamion	në pronësi ose me qera	copë	1
2	Kamiona vetshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5 - 5 ton për secilin kamion	në pronësi ose me qera	copë	1
3	Kamioncine	në pronësi ose me qera	copë	1
4	Kamion me vinc me kapacitet vinci mbi 5 ton	në pronësi ose me qera	copë	1
5	Fadrome me goma për transport dheu	në pronësi ose me qera	copë	3
6	Minifadrome	në pronësi ose me qera	copë	1
7	Minieskavator 4-5 ton	në pronësi ose me qera	copë	1
8	Motogjenerator/Gjeneratore	në pronësi ose me qera	copë	1
9	Vibrator	në pronësi ose me qera	copë	1
10	Kompaktor ngjeshes	në pronësi ose me qera	copë	2
11	Betonjere	në pronësi ose me qera	copë	1

12	Vibrator betoni	në pronësi ose me qera	copë	1
13	Trencher per hapje kanali dhe prerje asfalti	në pronësi ose me qera	copë	1
14	Rrul me kompresor	në pronësi ose me qera	copë	1
15	Saldatrice	në pronësi ose me qera	copë	1
16	Çekic pneumatic per thyerje betoni	në pronësi ose me qera	copë	1
17	Pajisje e lëvizshme me ultratinguj për matjen e rrjedhjes/prurjes ( Pajisja digitale )	në pronësi ose me qera	copë	1

Mjete dhe paisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier"(i ndryshuar) me VKM-në nr.563, datë 03.07.2013 "Për miratimin e rregullores për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndeti për përdorimin e paisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës", dhe VKM-në nr.564, datë 03.07.2013 "Për miratimin e rregullores për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës" si më poshtë vijon:

- Kokore mbrojtëse minimumi 30 (tridhjetë ) copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 2 (dy) copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 10 (dhjetë) copë
- Karroca dore minimumi 10 (dhjetë) copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 (njëzet) copë
- Fikse zjarri 10 (dhjetë) copë
- Jelekë minimum 30 (tridhjetë ) copë

*Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshëm), Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme),Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqërohet me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e lidhur para noterit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi si dhetë shoqërohet me aktin e pronesise se qeradhenesit. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.*

- a) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- b) *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedurat të shpallura fitues (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).*
- c) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*

2.3.12 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues për materialet ( *Tuba te brinjezuar HDPE SN8* ), të pasqyruara në Shtojcën 5 "Formulari i specifikimeve teknike", duhet të paraqesë: Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve lëshuara/publikuara nga prodhuesit/ distributorët zyrtarë ose skedat teknike të lëshuara/publikuara nga prodhuesit/distributorët zyrtarë, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të mallrave sipas kërkesave të DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse mallrat e ofruara të cilat do të përdoren në kryerjen e shërbimeve, plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

2.3.13 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Çertifikatë Konfirmiteti CE dhe raportet e testimit, të lëshuara nga ente certifikues të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë për produktet objekt prokurimi të cilat do të përdoren në shërbimet e mirëmbajtjes të parashikuara sipas preventivit të publikuar, për të cilët janë kërkuar standarte teknike kombëtare apo ndërkombëtare të miratuara, të specifikuara në Shtojcën 5 Specifikimet Teknike, me qëllim vërtetimin e përmbushjes standarteve teknike të kërkuara.

**Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit.** Dokumentacioni provues, i cili vërteton se operatori ekonomik disponon mjetet sa me sipër, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet mbi makineritë sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

---

## FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik  
\_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

## A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

## B: DEKLARATË

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et


## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

<b>Deklarata</b>
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

## **B: DEKLARATA “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura”**

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
  - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
  - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
  - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;

- 
- b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

- 
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
- çmimet ;
  - metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
  - qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
  - paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

### C: DEKLARATA “Mbi Konfliktin e Interesit”

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:
Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.
Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.</li> <li>- Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.</li> </ul>
Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli



rajonat, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

#### **D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”**

##### **Deklarata**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
